



FORÇA JONË

*** Viti IV • Nr. 34 • Maj 2015 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës ***

Ministri i MFSK-së, Haki Demolli, në Panairin Ndërkombëtar të Armëve në Kroaci

Me ftesë të ministrit të Mbrojtjes së Kroacisë, Ante Kotromanovic, në hapjen solemne të Panairit Ushtarak Ndërkombëtar, që u mbajt në Split, mori pjesë ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës Haki Demolli me një delegacion të FSK-së. Hapja solemne e Panairit të industrisë ushtarake, ushtrimi detar dhe konferenca u mbajt në arena Spaladium të Splitit, ku morën pjesë ministri i Mbrojtjes së Kroacisë, Ante Kotromanovic, shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura të Kroacisë, gjenerali Drago Lovriq, ministri i FSK-së, Haki Demolli, ministri i Mbrojtjes i Bosnjës dhe Hercegovinës, ministri i Sllovakisë si dhe shumë delegacione ushtarake të ushtrive të rajonit dhe botës. Gjatë mbajtjes së panairit të armëve në



Split, u mbajt edhe një demonstrim ushtarak i Forcave të Armatosura të Kroacisë, me pjesëmarrjen e forcave detare, ajrore etj. Ekspozita e industrisë ushtarake u mbajt nën patronazhin e Qeverisë së Kroacisë, ku morën pjesë më shumë se 119 kompani vendore, rajoni dhe bota, organizuar nga "TNT ProductionInc" nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gjatë qëndrimit në Kroaci, ministri Demolli u takua me ministrin e Mbrojtjes së Kroacisë, Ante Kotromanovic, si dhe me personalitete civile dhe ushtarake të shteteve pjesëmarrëse në Panairin Ndërkombëtar të Armëve në Split. Panairi qëndroi i hapur për tri ditë rresht, ku vizitorët patën mundësi të njihen me të arriturat e fundit në zhvillimin e pajisjeve ushtarake dhe armëve më moderne.

Konferenca e bashkëpunimit ndërkombëtar "FSK dhe partnerët"

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), më 28-29 prill u mbajt konferenca dy ditore, "FSK dhe partnerët", me organizim të Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Siguri të MFSK-së, në të cilën morën pjesë: ministri i MFSK-së, Haki Demolli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, gjeneral brigade Zymer Halimi, gjeneral brigade Bashkim Jashari, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, drejtori për Politika dhe Plane Faruk Geci, shefi i Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Naim Haziri, drejtori i Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s për FSK-në (NLAT), gjeneral brigade Werner Hauman, atashetë ushtarakë të vendeve si: Republika e Shqipërisë, Kroacisë, SHBA-ve, Turqisë, Gjermanisë, Mbretërisë së Bashkuar, Italisë dhe pjesëmarrës tjerë nga fusha e sigurisë, qoftë të misioneve ndërkombëtare dhe të MFSK-së dhe FSK-së. Qëllimi i konferencës së përbashkët "FSK dhe partnerët", është rritja e ndërsjellë e bashkëpunimit dhe ndërveprimit në mes të partnerëve, po ashtu edhe ekipet këshilluese të NATO-s, për Ministrinë (NAT) dhe Ekipit Këshillues Ndërlidhës të

NATO-s, për FSK-në (NLAT), si organizma mbështetës të Ministrisë së FSK-së dhe të FSK-së. Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Haki Demolli, pasi shpalli të hapura punimet e konferencës "FSK dhe partnerët" tha se është një vërtetë e pranuar gjerësisht, se FSK-ja paraqet një tregim të suksessit në Republikën e Kosovës dhe për këtë opinion të krijuar në vendin tonë lidhur me FSK-në, një meritë e madhe i takon mbështetjes së ofruar nga ju si partnerë, çoftë përmes ndihmës së drejtpërdrejtë dypalëshe, e po ashtu edhe përmes mbështetjes profesionale siç janë ekipet këshilluese të NATO-s për Ministrinë (NAT) dhe Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s për FSK-në (NLAT), apo edhe përmes formave të tjera të përkrahjes. Në vazhdim ministri Demolli tha gjithashtu se: "Takimet e këtuja, sikurse kjo konferencë janë të vlefshëm për koordinim dhe mbështetjen e mëtejshme të FSK-së." Në fund të fjalës së tij ministri Demolli tha se duke pasur parasysh procesin në të cilin ndodhemi është më se e nevojshme që të kemi një harmonizim të veprimeve me qëllim që mbështetja e vendeve tuaja të jetë adekuate për fushat e caktuara, e ku përfituesi kryesor do



jemi ne si Ministri e FSK-së. Nga ana e tij, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama tha se e vlerësojmë lartë gatishmërinë e vendeve partnere dhe vendeve pjesëmarrëse në konferencë, e gjithashtu gatishmërinë e shprehur në vazhdimësi për të përkrahur FSK-në në mirëmbajtjen e kapaciteteve themelore, si dhe mbështetjen që vendet tuaja kanë dhënë për FSK-në. Më tej gjeneral Rama shtoi: "Siç dihet FSK-ja është duke punuar ngushtë me partnerët në përgatitjet për zba-

timin e rekomandimeve të Rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë e cila si e tillë paraqet një sfidë në vete." Përgatitja për zbatimin e rekomandimeve dhe për procesin e transformimit të FSK-së në Forcën e ardhshme do të bëhet padyshim në bashkërendim të ngushtë me të gjithë partnerët tanë, theksoi komandanti i FSK-së. Në vazhdim të konferencës "FSK dhe partnerët" u paraqit kolonel Bashkim Shillova, shefi i Sektorit të Operativës dhe Trajnimit në Komandën e Forcave Tokësore

(KFT) të FSK-së, i cili paraqiti temën: "Programi i punës së FSK-së dhe NLAT-it për vitin 2015", pastaj kolonel Ilir Qeriqi, shefi i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në Ministrinë për FSK, i cili referoi për temën: "FSK dhe bashkëpunimi me partnerët". Konferenca vazhdon punimet edhe nesër, me paraqitjet e oficerëve të shumë vendeve pjesëmarrëse, ndërsa mbyll punimet në orët e pasdites. Kjo është konferenca e dytë e këtij lloji, e para është mbajtur në vitin 2014.

Ministri dhe Komandanti i FSK-së takuan ambasadorin e ri të Mbretërisë së Bashkuar

Ministri i FSK-së, z. Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtnant Rrahman Rama priten më 27 prill 2015, në takime të ndara ambasadorin e ri të Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, z. Ruairi O'Connell. Ministri i FSK-së Haki Demolli i shoqëruar edhe nga zëvendësministri Fadil Gashi, priti në takim ambasadorin e ri të Mbretërisë së Bashkuar zotin Ruairi O'Connell i cili shoqërohej edhe nga atasheu ushtarak i Ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, nënkolonel Richard Parry, dhe drejtori i Ekipit Këshillues të NATO-s (EKN) në MFSK, zoti Dominic Braitwait, Ministri Demolli pas urimit për emërimin në detyrën e ambasadorit në Kosovë, zotit Ruairi O'Connell i shprehi falënderimet për bashkëpunimin e thellë dhe dinamik që ka ekzistuar në mes MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së

Bashkuar, duke vlerësuar lartë ndihmën e madhe që është dhënë në trajnimin dhe shkollimin e oficerëve të lartë të FSK-së në akademitë ushtarake elitare të Mbretërisë së Bashkuar si dhe me dërgimin e grupeve të instruktorëve ushtarak në Kosovë për të bashkëpunuar me FSK-në. Gëzon fakti se i gjithë ky bashkëpunim zhvillohet mbi Memorandumin e Bashkëpunimit në mes të MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar të nënshkruar që në vitin 2009, e që ishte memorandum i parë i bashkëpunimit të MFSK-së me një Ministri të Mbrojtjes. Po ashtu ministri Demolli e njoftoi ambasadorin edhe mbi zhvillimet e procesit për transformim e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës (FAK), si dhe veprimet e kryera nga MFSK deri me sot që janë të nevojshme për këtë transformim, me objektivi të përhershëm për anëtarësim në

NATO. Nga ana e tij ambasadori Ruairi O'Connell, shprehi gatishmërinë për të vazhduar bashkëpunimin. Komandanti i FSK-së gjenerallejtnant Rrahman Rama në takimin që pati me ambasadorin Ruairi O'Connell, filimisht e uroi për emërimin në detyrën e re të ambasadorit të Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë. Komandant Rama e njoftoi ambasadorin nga Mbretëria e Bashkuar për fazën e aktivitetëve të FSK-së, bashkëpunimin me NATO-n dhe bashkëpunimin e mirë me ushtritë e shteteve të rajonit. Ai falënderoi kontributin e Ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar në trajnimin e oficerëve dhe ushtarëve të FSK-së, qoftë përmes trajnimeve në Mbretërinë e Bashkuar, qoftë përmes instruktorëve që vijnë në FSK, dhe sidomos ai çmoi lartë pjesëmarrjen në ushtrime fushore të përbashkëta. Komandant Rama



po ashtu foli edhe për përgatitjet dhe planifikimet e kryera për nevojat e transformimit të FSK-së në FAK, duke u angazhuar çdo herë se FAK do të jenë forcë për të mirë dhe në shërbim të sigurisë së rajonit dhe më gjerë. Nga ana e tij ambasadori Ruairi O'Connell

përgëzoi komandant Ramën për arritjet e deritashme në ngritjen e strukturës së FSK-së. Ai e vlerësoi si një e arritur e përbashkët, që Kosova nga konsumues i sigurisë po transformohet në eksportues të sigurisë përmes bashkëpunimit me ushtritë e rajonit dhe me NATO-n

Ministria e FSK-së dhe Ministria e Mbrojtjes së Norvegjisë me projekte të përbashkëta

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes të Ministrisë së Mbrojtjes të Norvegjisë (CIDS), më 21 prill 2015, në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) lansuan dy projekte: "Mbështetja për sistemin e menaxhimit të resurseve njerëzore në MFSK" dhe "Forcimi i integritetit të kornizës punuese në MFSK". Qëllimi i këtyre projekteve është të mbështesë MFSK-së në një periudhë kohore prej tri vitesh, si dhe të kontribuojë në krijimin e një integriteti publik më të mirë të kornizës punuese, duke reduktuar rreziqet institucionale të korrupsionit e promovimit dhe profesionalizimit meritokratik në MFSK. Ministria e Mbrojtjes së Norvegjisë përmes CIDS, ka premtuar angazhimin e saj për të mbështetur qeverisjen demokratike dhe mekanizmat e kontrollit të MFSK-së. Në fjalën e tij tematike, Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj tha: "Përmes këtyre projekteve, po hapim një kapitull të bashkëpunimit bilateral në mes të dy ministrive, Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së



Norvegjisë. Fjala është për dy projektet e iniciuara bashkë me Qendrën e Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes së Norvegjisë që kanë të bëjnë me fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore në MFSK dhe ngritjen e integritetit në MFSK. Edhe pse dy projekte të ndara, që të dyja janë komplementare sepse për qëllim final kanë ngritjen e kontrollit civil demokratik në MFSK dhe fuqizimin e parimeve të qeverisjes së mirë. Fakti që dy projektet janë tre-vjeçare, tregon angazhimin tonë të përbashkët me Qendrën e Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes së Norvegjisë. Kontributi i Norvegjisë në reformën e sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë

është shumë i nevojshëm dhe shumë i mirëseardhur për MFSK-në. Ne presim që kjo mbështetje e çmuar do të bëhet formale nëpërmjet një marrëveshje bashkëpunimi ndërshtetërore, përkatësisht ndërmjet MFSK-së dhe MM së Norvegjisë. Kësisoj do të forconim edhe më shumë karakterin e bashkëpunimit". Gjithashtu, Sekretari Sylaj u shpreh i bindur në thellimin e bashkëpunimit në mes të këtyre dy ministrive "Ne jemi të bindur që përvoja juaj në funksion të qeverisjes së mirë do të jetë tejet e nevojshme për konsolidimin e MFSK-së dhe përqafimin e kriterëve të NATO-së. Ai shprehi përkushtimin e MFSK që të jetë

shumë bashkëpunues dhe të ofrojë gjithë gatishmërinë me qëllim të arritjes së objektivave të këtyre projekteve. Ne do të punojmë në masa të veçanta kundër të gjitha dukurive negative duke marrë për bazë parimet e definuara me programin e NATO-s, BE-së dhe SHBA-ve, për ngritjen e Integritetit (Building Integrity Programme). Për këtë u jemi mirënjohës Qendrës së Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes së Norvegjisë për këtë mbështetje", përfundoi fjalën e tij, Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj.

Para të pranishmëve foli edhe zëvendësministri i MFSK-së, z. Fadil Gashi i cili tha se iniciativat që kanë për qëllim ngritjen e bashkëpunimit dhe bashkëveprimin ndërshtetëror, do t'i shërbejnë në mënyrë të drejtpërdrejtë fuqizimit të kontrollit civil demokratik në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Ndërsa ambasadori i Norvegjisë Jan Braathu tha se integriteti dhe qeverisja e mirë janë të rëndësishme për të gjitha vendet. Korrupsioni ndikon në tërë shoqërinë dhe në fund të fundit

vetë shtetin. Pjesëmarrja e Kosovës në Programin "Building Integrity" është shumë e rëndësishme. Ai gjithashtu sjell Kosovën më afër procesit të saj të integritetit në NATO. Gjithashtu me një fjalë tematike u inkuadrua z. Svein Eriksen (Center for Integrity). Prezantimin e këtyre projekteve "Mbështetje personelit dhe ngritja e integritetit në MFSK" e bëri Florian Qehaja udhëheqës i ekipit për Kosovë.

Në takimin ishin prezentë: Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së, Shkëlzen Sylaj, zëvendësministri i MFSK-së, z. Fadil Gashi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rrahman Rama, gjeneralbrigade Zymer Halimi, drejtori i Drejtorisë për Politikë dhe Plane në MFSK, Faruk Geci, ambasadori i Norvegjisë, Jan Braathu, Svein Eriksen (Center for Integrity), përfaqësues të ambasadave në Kosovë, atasheu ushtarak të ambasadave të akredituara në Kosovë, drejtori i Ekipit Këshillues të NATO-s, (NAT) Dominic-Haydn Braithwaite, zyrtar të Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s (NLAT), KFOR-it, këshilltarja e MODA-së, znj. Meg Ardner, zyrtarë dhe oficerë të lartë të MFSK-së dhe FSK-së.

Komandanti i FSK-së mori pjesë në shënimin e 100-vjetorit të Betejës së Çanakalës në Turqi

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtnant Rrahman Rama me ftesë të Qeverisë së Republikës së Turqisë, më 28 prill mori pjesë në aktivitetet për shënimin e 100 vjetorit të Betejës së Çanakalës, e njohur si Fushata Luftarake e Galipolit, betejë e zhvilluar gjatë kohës së Luftës së Parë Botërore. Gjenerallejtnant Rrahman

Rama së bashku edhe me zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçin si dhe ambasadorin e Kosovës në Republikën e Turqisë Avni Spahiun morën pjesë në ceremoninë e zhvilluar në Çanakala, ku përveç homazheve dhe ceremonive tjera në kujtim të Betejës, gjeneral Rama zhvil-



loi edhe disa takime me disa prej homologëve të tij, pjesëmarrës në ceremoni. Gjatë qëndrimit në Turqi, gjeneral Rrahman Rama ishte pjesë edhe e Samitit të Paqes, në të cilin morën pjesë edhe shumë personalitete politike e ushtarake si nga Australia, Zelanda e Re, Mbretëria e Bashkuar, Iraku, gjithashtu vendet e Ballkanit etj.

Komandanti i FSK-së gjeneralletenant Rrahman Rama vizitoi KDS-në

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletenant Rrahman Rama i shoqëruar nga këshilltari i tij nga Britania e Madhe, nënkolonel David Jones dhe ndihmës atashu ushtarak i ambasadës Amerikane në Prishtinë, major Thomas Melton, më 15 prill 2015, vizituan Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj. Gjatë vizitës ata u takuan me komandantin e KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, me të cilin diskutuan për trajnimet të cilat janë duke u realizuar në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, si dhe vizituan rekrutët në Kursin Bazik. Gjeneral Rama fillimisht i përgëzoi rekrutët e kursit bazik për përzgjedhjen e tyre që të jenë pjesë e FSK-së. Ai duke bashkëbiseduar me ta ndër të tjera iu tha se të qenit pjesë e FSK-së është nder për ju, por edhe krenari për familjet e juaja, sepse kjo është një nga mënyrat më të mira për t'i shërbyer vendit". Ju e keni rastin t'i kon-



tribuoni vendit tuaj, unë jam njoftuar nga komandanti juaj se ju jeni duke treguar përkushtim të lartë, në përpjekjet tuaja për të arritur rezultate sa më të larta dhe kjo na bënë të mburremi me punën e instruktorëve, me përkushtimin tuaj dhe angazhimin e tërë stafit që kursi të përfundojë me sa më shumë sukses". KOMFSK bisedoi edhe me instruktorët me të cilët diskutoi për sfidat e mundshme, por edhe kërkoi nga ta që të vazhdojnë me përkush-

timin e njëjtë deri në finalizimin e këtij programi. Gjeneral Rama e pa nga afër demonstrimin e aftësive të rekrutëve në pjesën praktike të trajnimeve, pjesë e planit të stërvitjes në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, për të cilin tha se e gëzon fakti që rekrutët kanë arritur ta kuptojnë dhe ta demonstrojnë një plan taktik për një periudhë relativisht të shkurtër, e cila pa përkushtimin e rekrutëve dhe angazhimin e instruktorëve nuk do të ishte e mundur të ndodh.

Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së nderoi me mirënjohje këshilltaren e NATO-s

Zonja Anda Kemme ka qenë këshilltare ligjore në Ekipin Këshillues të NATO-s, e cila ka mbështetur Departamentin Ligjor në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK). Znj. Kemme ka ardhur nga Ministria e Mbrojtjes së Letonisë dhe ka shërbyer si këshilltare ligjore për 2 vite në MFSK. Me rastin e përfundimit të mandatit të saj, në një ceremoni modeste, më 23 prill, znj. Kemme është pritur nga Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj. Në takim ishin të pranishëm edhe drejtoresha e Departamentit Ligjor, znj. Krenare Sogojeva-Dërmaku, shefi i Ekipit Këshillues të NATO-s, z. Dominic Braitwait dhe Vineta Kleine këshilltare e Ekipit Këshillues të NATO-s. Me këtë rast, z. Sylaj falënderoi znj. Kemme për kontributin e saj



dhënë Departamentit Ligjor të MFSK-së, si këshilltare ligjore. Me këtë rast, z. Sylaj në emër të ministrit të FSK-së, z. Demolli e nderoi me mirënjohje znj. Kemme për punën dhe kontributin e dhënë gjatë kohës sa

a ajo ka shërbyer në MFSK. Znj. Kemme e falënderoi z. Sylaj, për pritjen që i është bërë, për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm që ka pasur në Ministrinë e FSK-së dhe Departamentin Ligjor, si dhe për Mirënjohjen që iu dha.

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës u mbajt "Java e NATO-s"

Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, nën organizimin e Asociacionit të Paktit Atlantik të Rinisë së Kosovës (KYATA) së bashku me Departamentin për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak dhe Departamentin për Siguri dhe Bashkëpunim të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, më 14 prill u mbajt "Java e NATO-s". Në seminarin "Java e NATO-s dhe Simulimi i Këshillit Atlantik" morën pjesë studentë përfaqësues të SHBA-ve, Turqisë, Shqipërisë, Maqedonisë, Italisë, Bullgarisë, Serbisë, etj. Kryetari i Asociacionit të Paktit Atlantik të Rinisë së Kosovës "KYATA" z. Besim Salihua tha: "Ne në takimin e sotëm, që është vazhdim i aktiviteteve tona, e



simuluar Këshillin e NATO-s dhe e trajtuam krizën e Ukrainës si dhe pushtimin e saj nga Rusia. Punimet e seminarit i përshëndetën gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione, z. Faruk Geci, drejtor

i Departamentit për Politika dhe Plane si dhe Dominik Braitwait, shef i Ekipit Këshillues të NATO-s në MFSK (NLAT). Të gjithë pjesëmarrësit e seminarit kontribuan me fjalimet e tyre që të mbahet me sukses "Java e NATO-s".

Njësia e Kërkim-Shpëtimit e FSK-së gjeti trupin e Sead Alushit në lumin Ibër

Ekipi i kërkim-shpëtimit në ujëra i Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së, pas 19 ditësh të operacionit të kërkimeve në lumin Ibër të Mitrovicës, më 28 prill 2015, rreth orës 13.00 e gjeti trupin e pajetë të Sead Alushit 17 vjeç, nga fshati Suhadoll i Mitrovicës. Seadi, më 10 prill 2015, tek sa po tentonte ta kalonte lumin Ibër ishte mbytur. Gjatë 19 ditëve të kërkimit, FSK-ja kishte angazhuar çdo ditë një ekip profesionistësh në ujëra prej 17 deri 40 pjesëtarë (varësisht prej rrethanave) me 4 automjete, dy barka si dhe pajisjet specialitike për kërkim-shpëtimit në ujëra. Ekipi i FSK-së, trupin e pajetë të Sead Alushit e ka gjetur në lumin Ibër, vendin Rudare të Zveçanit, rreth orës 13.00, ndërsa më pas-taj është bërë identifikimi i tij, nga ekipi i mjekësisë ligjore. Gjatë operacionit ekipin e kërkim-shpëtimit të FSK-së në ujëra, i ka vizituar komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile kolonel Shaip Haziri, zyrtarë të Ministrisë së FSK-së dhe oficerë të FSK-së, në përkrahje të kërkimit të trupit të Sead Alushit.



Gjatë kohës së zhvillimit të operacionit, ekipi i kërkim-shpëtimit të FSK-së, ka gjetur në lumin Ibër edhe një trup të pajetë të një qytetari të moshës mbi 60 vjeç, të komunitetit serb. Ekipi i kërkim-shpëtimit të FSK-së, gjatë tërë kohës së operacionit u përkrah dhe pati një bashkëpunim të ngushtë me KFOR-in, Policinë e Kosovës, udhëheqjen e komunave, qytetarët dhe strukturat tjera komunale.



FSK-ja në shënimin e Ditës së Tokës

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenant Rrahman Rama së bashku me kryetarin e Komunës së Kastriotit, z. Xhafer Gashi, zëvendësministrin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, z. Ferat Shala dhe me bashkëpunëtorë vizituan fshatin Plemetin të Komunës së Kastriotit, ku në mënyrë simbolike filluan aksionin për pastrimin e mjedisit, me rastin e shënimit të "Ditës së Tokës" 22 prillit. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Rrahman Rama ka përgëzuar pjesëtarët e xhenios të FSK-së, të cilët janë angazhuar në pastrimin e mjedisit në fshatin Plemetin të banuar edhe me pjesëtarë të komunitetit serb, romë etj. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama tha: "Ne si FSK, e kemi dëshmuar dhe e dëshmojmë për çdo ditë që jemi në shërbim të qytetarëve pa dallim etnie. Ne do të vazhdojmë t'i përkrahemi institucionet, si ato komunale ashtu dhe ato qendrore, si dhe organizatat e ndryshme joqeveritare, por edhe vetë komunitetin. Është një gjë e mirë që ne, sadopak me mundësitë tona që i kemi, të krijojmë kushte sa më të mira, sepse ambienti është i rëndësishëm së veçantë për shëndetin e të gjithë qytetarëve" tha në fund komandanti i FSK-së gjeneral Rama. Ndërsa, zëvendësministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, z. Ferat Shala, shtoi "Sot jemi në vigjilje të Ditës Botërore të Tokës e cila shënohet në mbarë rruzullin tokësor. Praktikisht janë sfidat më të mëdha me të cilat shoqëria njerëzore ballafaqohet, në njërin anë me degradimet, eksploatimin dhe shfrytëzimin e resurseve të saj,



dhe në anën tjetër me sfidën e menaxhimit të gjithë nivelit shoqëror për përmirësimin e degradimeve, qoftë nga e kaluara, qoftë të tanishme". FSK-ja për pastrimin e mjedisit të fshatrave Plemetin dhe Babin Most ka angazhuar në terren 2 ngarkues dhe gjashtë kamionë me gjithsej 12 pjesëtarë të FSK-së, të cilët kanë bërë pastrimin e dy vendeve të mbeturinave. Ky aktivitet është realizuar edhe në bashkëpunim me Komunën e Kastriotit. Kryetari i Komunës së Kastriotit falënderoi pjesëtarët e FSK-së, të cilët me angazhimin e tyre ndihmuan në pastrimin e mjedisit të kësaj komune.



Kadetët e FSK-së me sukses realizuan ushtrimin fushor "Pëllumbi 2"



Qendra për Studime Universitare e Forcës së Sigurisë së Kosovës, prej datës 03-07. 04. 2015, ka realizuar ushtrimin fushor "Pëllumbi 2" në Zhegoc të Gjilanit.

Qëllimi i ushtrimit ishte përgatitja taktike në operacionet urbane ofensive dhe mbrojtëse si dhe testimi i gatishmërisë fizike dhe psikike të kadetëve. Gjatë real-

izimit të ushtrimit fushor, "Pëllumbi 2" kadetët e QSU-së, u përballen edhe me temat tjera, si operacionet urbane ofensive dhe mbrojtëse, evakuimi i të lënduarve nga fushëbeteja, navigimi tokësor ditën dhe natën, patrullimet, reagimi në kontakt etj. Për të përcjellë nga afër ushtrimin fushor të koduar me emrin "Pëllumbi 2" të kadetëve të



Qendrës për Studime Universitare, ishin edhe atasheu ushtarak i Mbrojtjes së SHBA-ve, koloneli Chud Butts, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërviçes (KDS) gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Kampit Bondsteel, koloneli Clinton Backer dhe oficerë të lartë të FSK-së. Me këtë rast, paraqitjen e kadetëve të FSK-së e

vlerësuan lartë, koloneli Butts, gjenerali Cikaqi dhe komandanti i QSU-së, kapiten Avni Kiçina i cili pos tjerash tha se "është arritur tërësisht qëllimi dhe objektivat e ushtrimit për përgatitjen e kadetëve të QSU-së, para ushtrimit final që do të mbahet në përfundim të vitit akademik". Ndërsa, komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi dhe atashe

ushtarak i Mbrojtjes i SHBA-ve, koloneli Butts u ndanë të kënaqur me përgatitjen dhe paraqitjen e shkëlqyeshme të kadetëve të FSK-së, gjatë mbajtjes të ushtrimit fushor "Pëllumbi 2". Koloneli amerikan Butts e vlerësoi lart angazhimin e instruktorëve dhe kadetëve të QSU-së, për punën e tyre të palodhshme gjatë përgatitjes së oficerëve të FSK-së.

Betohen 155 ushtarët e rinj të FSK-së, gjenerata e parë 2015

Sot në ambientet e kazermës "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërviçes të FSK-së, në Ferizaj, u mbajt ceremonia e certifikimit të 155 rekrutëve të rinj të FSK-së, gjenerata e parë 2015, të cilët për nëntë javë trajnimi intensiv e përmbyllin me sukses Kursin Bazik dhe treguan përkushtim të lartë në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve të dala nga programi i shkollës. Ministri i MFSK-së, z. Haki Demolli duke ju drejtuar rekrutëve-ushtarëve të rinj, shtoi: "Nuk ka mision më të shenjtë, se të jesh ushtarë në shërbim të mbrojtjes së lirisë dhe demokracisë, vlera dhe parime këto për të cilat gjenerata të tëra kanë sakrifikuar. Të qenit pjesëtarë të FSK-së është kënaqësi, detyrë dhe nderë për ju, që të jeni në shërbim të sigurisë, duke qenë të gatshëm në çdo moment për t'u aktivizuar në detyra dhe misione që janë në të mirë të sigurisë së shtetit të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve, pa dallime kombi, race apo gjinie". Ministri Demolli falënderoi stafin trajnues të KDS-së, për angazhimin e tyre të pakursyer në realizimin e këtij trajnimit, për të shtruar: "Niveli i trajnimit tuaj bazik me standarde të ushtrive më moderne, është një shembull i qartë i zhvillimit dhe progresit që po e bën FSK-ja në profesionalizimin e saj. Ju po certifikoheni në një moment të rëndësishëm të ndërtimit kapaciteteve mbrojtëse të shtetit tonë. Në kohën kur janë bërë planifikimet dhe përgatitjet e duhura për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës (FAK). Ky transformim sjell mision dhe perspektivë të re për të gjithë, por veçanërisht hapë mundësi më të

mëdha për zhvillimin e karrierës tuaj ushtarake. Prandaj kjo mundësi e re duhet t'ju motivojë edhe më shumë për realizimin e detyrave që dalin para jush gjatë kryerjes së shërbimit në FSK". Në fund, ministri Demolli uroi ushtarët e rinj, me dëshirën për të treguar suksese në detyrat e reja dhe njëherësh kërkoi angazhimin e tyre në stërviçje, në



kuadër të strukturës së FSK-së, me qëllim të realizimit të objektivave të deklaruar për ta bërë FSK-në, forcë profesionale dhe efikase të sigurisë në të mirë të Kosovës dhe gjithë qytetarëve të saj. Ndërsa, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rahman Rama në fjalën e tij, tha: "Ky është vetëm fillimi i rugëtimit tuaj në një profesion fisnik. Gjatë karrierës tuaj, ju do të ballafaqoheni me sfida të ndryshme. Por, gjithmonë mbani në mend, që ne jemi në shërbim të vendit atëherë kur vendi ka nevojë më së shumti për ne. FSK-ja është forcë e besueshme,

profesionale dhe forcë për të mirë të vendit dhe rajonit. FSK-ja është duke vepruar në gjithë territorin e vendit duke i mbështetur autoritetet civile dhe qytetarët e Kosovës pa dallime. FSK-ja është duke marrë pjesë në ushtrimet regjionale të barabarta me të gjitha ushtritë e rajonit. Ne jemi të përkushtuar që të zhvillohemi profesionalisht në mënyrë që gjithmonë të jemi të gatshëm t'u përgjigemi nevojave të shtetit dhe qytetarëve të Kosovës, si dhe rajonit. Ne jemi të përkushtuar që të bëhemi vend kontribuues i sigurisë regjionale dhe globale". Komandanti i FSK-së për të gjitha të arriturat dhe zhvillimet profesionale të rekrutëve të rinj të FSK-së, ka falënderuar dhe përgëzuar stafin e KDS-së, familjarët e ushtarëve të rinj, si dhe në veçanti partnerët ndërkombëtarë. Në emër të Komandës së Doktrinës dhe Stërviçes me një fjalë ka përshëndetur, komandanti i Qendrës Bazike majori Sami Hajrullahu. Në fund të ceremonisë rekrutët e rinj solemnisht dhanë betimin. Në ceremoninë e betimit të rekrutëve të rinj, morën pjesë: ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rahman Rama, zëvendës komandanti i KDS-së, koloneli Irfete Spahiu, atasheetë ushtarakë, shefi i NLAT-it, gjeneral brigade Werner Haumann, drejtor i NAT-it, z. Domenic Braitwait, oficerë të lartë të FSK-së dhe të KFOR-it, si dhe familjarë të shumë të rekrutëve. Në fund, instruktorëve iu dhanë mirënjohje për punën e tyre të suksesshme, ndërsa rekrutëve certifikatat për kryerjen me sukses të Kursit Bazik.



U certifikuan kadetët në kursin e karrierës për nënoficerë të FSK-së

Në ambientet e kazermës "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj, u mbajt ceremonia e certifikimit të kadetëve në kursin e nënoficerëve të FSK-së. Këtë kurs janë të obliguar ta kryejnë të gjithë nënoficerët e gradave tatar e kapter, dhe cilësohet si kurs i cili ofron mundësi karriere për nënoficerët, duke i pajisur me njohuri të reja dhe përvojë shtesë. Komandanti i KDS-së gjeneral brigade Enver Cikaqi, me këtë rast i përgëzoi të gjithë kadetët dhe instruktorët e tyre, për angazhimin, disiplinën dhe nivelin e arritjes profesionale që treguan gjatë kësaj periudhe shtatë javore. "Këtë gjeneratë të nënoficerëve, ne do ta kemi si model se si duhet të jetë një nënoficer në klasë të mesimit, por

edhe në ushtrimet fushore dhe taktike në terren", tha gjeneral Cikaqi. Ai shtoi se, "nënoficeri si në çdo ushtri është edhe tek ne është boshti kurrizor i ushtrisë dhe e ka vendin e duhur brenda çdo formacioni. Ne ofrojmë kurse trajnimesh të ndryshme për të gjithë pjesëtarët e FSK-së, por kursi i nënoficerit është i rëndësishëm së dyfishtë; në njërin anë përfiton njësia nga trajnimi i nënoficerit dhe në anën tjetër pjesëtarit merr njohuri të reja për zhvillim të karrierës. Pas përfundimit të këtij kursi, secili prej jush do të jeni një udhëheqës i mirë dhe do të mbështesni fortë komandantët tuaj, andaj kërkoj nga ju që të tregoni vetë iniciativë dhe përkushtim, ashtu siç keni treguar për këto shtatë javë, këtu në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes"- përfundoi

fjalën e tij, komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi. Kadetët gjatë këtij trajnimi u njoftuan me disa nga këto tema: Koncepti zhvillimor i nënoficerit, shkathhtësitë e komunikimit, teknikat e ligjërimit, navigimi tokësor, manuali i taktikave, ndihma e parë, rregulloret meshtore etj. Kursi i nënoficerit zhvillohet në mënyrë të kombinuar teori dhe praktikë. Si finalizim i kursit të nënoficerëve është mbajtur edhe një ushtrim fushor i nxjerr nga Manuali i taktikave dhe ndihma e parë dhe ka zgjatur tri ditë në terren, duke filluar me rregullimin e kampit dhe demonstrimin e aftësive fizike dhe profesionale. Për kadetët të cilët treguan rezultate të larta dhe përkushtim në punë u ndanë mirënjohje nga Qendra për Zhvillim Profesional e



Udhëheqësve. Me mirënjohje për arritje akademike u nderua tetari Bujar Trena, për standard të lartë të udhëheqjes tetari Valon Geci, për disiplinë tetari Halim Vrella, për arritje të standardit në fitnes fizik tetari Valmir Murtezi, ndërsa çmimi i

komandantit i takoi meshterit Fadil Bungu. Certifikatat kadetëve u dhanë komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi dhe zëvendëskomandanti i Qendrës për Zhvillim Profesional të Udhëheqësve, major Skënder Haliti.

Rreshteri Fadil Bungu, ushtari më i mirë në kursin e karrierës të nënoficerëve



Në kursin e nënoficerëve të mbajtur nga data 02 mars 2015 deri më 17 prill 2015, në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, u nda çmimi kryesor për arritje të jashtëzakonshme "Çmimi i komandantit", i cili takoi meshterit Fadil Bungu. Fadil Bungu është pjesëtar i Kompanisë së Mirëmbajtjes në Batalionin e Logjistikës të Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO). Ai ka marrë pjesë në shumë trajnime si brenda dhe jashtë vendit, ku në të gjitha trajnimet, stërvitjet, kurset është dalluar për angazhimin, disiplinën dhe arritjen e rezultateve të mira. Në të gjitha këto trajnime, Bungu është dalluar me paraqitjen e shkëlqyeshme. Ai thotë se ka kryer trajnimin themelor në Vushtri, trajnimin (10 muaj) në Gjermani, trajnimin për kërkimin, zbulimin dhe asgjësimin e mjeteve të

improvizuara shpërthyes (si municione, granata të llojeve të ndryshme, bomba si dhe mjete jo ushtarake), EOD dhe IED. Njëri ndër trajnimet më të rëndësishme për Fadilin, padyshim që mbetet "Kursi i Avancuar për Lider" (KAL), pastaj trajnimi i mbajtur nga Njësia Trajnuese e Ushtrisë së Turqisë, që vepron në kuadër të KFOR, për oficerë dhe nënoficerë; trajnimi për grumbullimin, ruajtjen dhe asgjësimin e municioneve të armëve të lehta (vogla) të marruara nga duart e qytetarëve të Kosovës (këto municione të mbledhura nga Policia e Kosovës që të ketë sa me shumë siguri për qytetarët tanë, gjatë këtij trajnimi "kemi asgjësuar rreth 18,000 fishekë të kalibrave të ndryshëm"); trajnimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), trajnimi me Policinë e Kosovës etj. Kurset

dhe trajnimet e fundit janë më të freskëta për secilin kadetë, edhe për mua, Kursi Bazik i Nënoficerëve ka një peshë dhe vlerë të madhe; perspektivën e çdo pjesëtarit të FSK-së. Gjatë këtij kursi kemi mësuar shumë tema të rëndësishme për ngritjen tonë profesionale, si: taktikat e lëvizjes, orientimi në natyrë, ushtrimi fushor, lidershipi, shkathhtësitë e udhëheqjes, lufta urbane, etj, të cilat i kemi përmbjllur me ushtrimin fushor treditor, mbajtur natën dhe ditën. Ky çmim për mua ka domethënie të vet, sepse më bën të ndihem mirë dhe në anën tjetër më jep impulse për suksese të përgjithshme jo vetëm në aspektin individual por edhe atë kolektiv". Fadili krenohet me atë se në FSK të gjithë ata që e kryejnë kursin bazik e meritojnë ta marrin këtë çmim", shprehet në fund meshter Bungu.

Trajnim i përbashkët i FSK-së me Gardën Kombëtare të Ajevës

Në kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) u organizua ceremonia e certifikimit të 48 pjesëtarëve të FSK-së, të cilët prej datës 15 deri më 17 prill 2015 kryen me sukses dy seminare; "Qendra Operative Luftarake" në të cilën morën pjesë

20 pjesëtarë dhe seminarin "Komanda dhe Kontrolli" të cilin e kryen 28 pjesëtarë nga njësi të ndryshme të FSK-së. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletënant Rrahman Rama, me këtë rast, falënderoi ekipin e instruktorëve të marinsave

amerikanë për kryerjen me sukses të këtyre seminareve dhe Ambasadën Amerikane në Prishtinë. Gjeneral Rama vlerësoi lartë mbajtjen e seminareve që u realizuan gjatë këtyre ditëve të cilat ishin të rëndësishme për FSK-në, dhe kërkoi që këto njohuri të gjithë pjesëtarët t'i realizojnë me sukses tek pozicionet e tyre.

Ceremoninë e certifikimit e hapi togeri Cavanaugh i Marinsave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i cili u shpreh mjaft i kënaqur me realizimin e këtyre seminareve dhe njëherësh i falënderoi të gjithë pjesëtarët e FSK-së për interesimin dhe angazhimin e treguar gjatë këtyre ditëve për të fituar njohuri dhe eksperiencë të reja. Në fund, gjeneralletënant Rrahman Rama i nderoi me mirënjohje instruktorët amerikanë të cilët kontribuan në mbajtjen e këtyre trajnimeve.



Ministri dhe komandanti duke nderuar dëshmorët e Betejës së Koshares

Në përvjetorin e 16 të Betejës së Koshares, më 8 prill 2015, ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës z. Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjeneralletënant Rrahman Rama së bashku me një delegacion të Ministrisë dhe të FSK-së, në nderim të dëshmorëve dhe të rënëve për Liri, bënë homazhe dhe vendosën lule në Varrezat e Dëshmorëve të Brigadës 138 "Agim Ramadani" në Koshare. Ministri dhe komandanti i FSK-së morën pjesë edhe në Manifestimin "Ditët e Shqipërisë" të mbajtur në patronazhin e kryeministrit të Kosovës, z. Isa Mustafa.

Intervistë me komandantin e KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi

FSK-ja në Konferencën Ndërkombëtare mbi Fuqinë e Hapësirës Ajrore në Turqi e barabartë me ushtritë pjesëmarrëse



"Forca Jonë": Zoti gjeneral, çka mund të thoni për pjesëmarrjen tuaj në konferencën ndërkombëtare të mbajtur në Stamboll. ?

Gjeneral Enver Cikaqi: Me ftesë të komandantit të Forcave Ajrore të Turqisë Gjeneral Akin OZTURK kam marrë pjesë duke përfaqësuar Forcën e Sigurisë së Kosovës në Konferencën Ndërkombëtare mbi Fuqinë e Hapësirës Ajrore. Komandanti i FSK gjenerallejtnant Rrahman Rama më ka autorizuar të marrë pjesë në këtë konferencë të rëndësishme, jo vetëm për temat të cilat janë diskutuar por edhe rëndësinë e pjesëmarrjes në këtë ngjarje të përmasave ndërkombëtare të FSK dhe të vendit tonë.

"Forca Jonë": Çfarë do të thotë për Ju dhe për FSK-në pjesëmarrja në këtë konferencë?

Gjeneral Enver Cikaqi: Konferenca organizohet çdo vit dhe kjo është hera e dytë që FSK merr pjesë, ndërsa organizimi është bërë me qëllim të diskutimit rreth fuqisë së hapësirës ajrore të shteteve pjesëmarrëse, mundësitë e partisipimit dhe nevojat e angazhimit. Sot Forcat ajrore në çdo ushtri kanë një rol të veçantë. Suksesi i të gjitha operacioneve luftarake të krizave ndërkombëtare nuk do të ishte pa pjesëmarrjen e Forcave ajrore, aleancave të fuqishme mes shteteve mike dhe teknologjisë së avancuar që sot kanë Forcat ajrore të ushtrive të vendeve të shumta. Fatmirësisht, shumica e vendeve që ishin prezent në konferencë ishin shtete që kanë njohur vendin tonë dhe që kanë ofruar ndihmë edhe për FSK-në, në formë të ndryshme. Në këtë drejtim, ftesa për pjesëmarrje në këtë konferencë ndërkombëtare do të thotë se Turqia por edhe shtetet anëtare të NATO-s, kanë një qëndrim pozitiv ndaj FSK-së. Forca e Sigurisë së Kosovës nëpërmes takimeve dhe konferencave të tilla me karakter ndërkombëtar ka ndërtuar partneritet me disa nga shtetet e NATO-s dhe shteteve tjera që nuk janë pjesë e Aleancës. Dhe falë kësaj sot kemi edhe një pjesë të oficerëve dhe nënoficerëve të cilët shkollohen dhe trajnohen nëpër kolegje dhe shkolla të këtyre shteteve, ndërsa njëra prej tyre është edhe Turqia, ku pjesëtarët tanë janë duke i vijuar shkollimet.

"Forca Jonë": Cilat janë përvojat e pjesëmarrjes në konferencën ndërkombëtare?

Gjeneral Enver Cikaqi: Pjesëmarrja jonë në ICAP 15 në Stamboll ishte një mundësi e mirë për të marrë njohuri rreth komandim-kontrollit, zhvillimit të teknologjisë, ndërveprueshmërisë në mes të zhvillimit të hovshëm të teknologjisë dhe edukimit dhe stërvitjes së stafeve të Forcave Ajrore, rëndësisë së luftimit të për-bashkët të rreziqeve aktuale ndërkombëtare etj. Në këtë konferencë ndërkombëtare kanë marrë pjesë nivele të larta të përfaqësimit të ushtrive të shumta të NATO-s dhe sigurisht që ka qenë një përvojë e mirë, nga e cila kemi mësuar si në aspektin e organizimit po ashtu edhe rëndësinë që ka kjo konferencë. Gjeneral me katër vje nga Ushtria amerikane Ushtria e Turqisë, gjener-

bashkëpunimit edhe në të ardhmen mes FSK-së dhe ushtrisë turke. Në të gjitha takimet ishte një interesim i veçantë i tyre për t'u njohur me FSK-në dhe të arriturat, si dhe shprehnin edhe interesimin e tyre për të vizituar FSK-në dhe Republikën e Kosovës.

"Forca Jonë": Zoti gjeneral ju keni takuar edhe shumë kadetët të FSK-së të cilët studiojnë në Turqi, si i shihni arritjet e tyre në aspektin profesional?

Gjeneral Enver Cikaqi: Konferenca ndërkombëtare është mbajtur në ambiente të Kolegjit të Luftës në Stamboll, ku edhe dy oficerë tanë janë duke ndjekur shkollimin, si dhe një oficer tjetër tashmë ka përfunduar shkollimin dy vjeçar në Kolegjin e Luftës. Është kënaqësi kur dëgjoja për suksesin e oficerëve tanë, për përshtypjet e tyre për oficerët e FSK-së, që ishin jashtëzakon-



alë nga Franca, Spanja, Norvegjia, Suedia, Pakistani, etj., kanë prezantuar përvojat e tyre dhe organizimin e sistemit të edukimit dhe stërvitjes së Forcave ajrore të ushtrive të tyre. Unë vlerësoj shumë organizimin e kësaj konference, jo vetëm me panelet e krijuara të ligjëruesve, temat të cilat janë ligjërues por edhe protokollin e shkëlqyer të Forcave Ajrore Turke, që e ka bërë shumë të suksesshëm këtë ngjarje të rëndësishme.

"Forca Jonë": Gjatë konferencës keni pasur edhe shumë takime me pjesëmarrës të konferencës dhe personalitete tjera ushtarake të Turqisë. A mund të na thoni diçka më shumë?

Gjeneral Enver Cikaqi: Gjatë qëndrimit në Stamboll kemi pasur takime me gjeneral nga shtete si Turqia, SHBA, Spanja etj, me të cilët kemi biseduar për nevojat e bashkëpunimit dhe mundësinë e shkëmbimit të përvojave. Në çdo takim me këto delegacione, informuam miqtë tanë për të arriturat e FSK-së, nivelin profesional dhe nevojën e bashkëpunimit edhe në të ardhmen. Po ashtu, përveç pjesëmarrjes në këtë konferencë ne kemi vizituar edhe hapësirat e Kolegjit të Luftës së Forcave Ajrore të Turqisë dhe kemi biseduar me Komandantin e këtij institucioni të rëndësishëm për format e

isht të mira. Ata vlerësoheshin se janë shumë aktiv, tregojnë përkushtim të lartë në edukim dhe stërvitje, për çka flasin edhe rezultatet e tyre. Por, ishte edhe një vlerësim i veçantë që iu bënin oficerët instruktorëve turq, por edhe stafi i Kolegjit, se të gjithë oficerët e FSK-së janë edhe të shoqërueshëm si me pjesëtarët të ushtrisë turke, ashtu edhe me pjesëtarët të ushtrive tjera në kolegjet dhe akademitë tona, që mua më bëri të ndjehem kërenar. Në të njëjtën kohë pata rastin të takoj edhe disa oficerë dhe nënoficerë tjerë të cilët janë në Institutin e Gjuhëve të Huaja, ku pjesëtarët tanë janë duke mësuar gjuhën turke, për të ndjekur pastaj kurset profesionale në shkolla të ndryshme të Turqisë. Ndërsa gjatë takimit me pjesëtarët tanë e pamë se ishin të motivuar, tregonin se kanë marrë njohuri të mira gjatë shkollimeve dhe stërvitjeve, dhe se kjo periudhë ju ka shërbyer për të forcuar pozitën e tyre me njohuritë e marra. Gjithashtu kërkuam nga pjesëtarët tanë që të vazhdojnë ta përfaqësojnë FSK-në edhe në të ardhmen në mënyrë sa më dinjitoze, për arsye se ata janë edhe ambasadorët tanë në këto vende nga ku mund të përçojnë mesazh se si duket Forca e Sigurisë së Kosovës, çfarë organizimi ka dhe kështu mund të krijohet edhe një përshtypje për FSK-në, nga pjesëtarët të shumtë të ushtrive të NATO-s, të cilët kryejnë trajnimet bashkërisht.

Nga praktikat pozitive të FSK-së

Fuqizimi i rolit të gruas në institucionet e sigurisë

Major Remzie Zeqiraj, oficer për Marrëdhënie me Publikun në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), më 8 prill mori pjesë në konferencën "Fuqizimi i Rolit të Gruas në fushën e Sigurisë", me organizim të Asociacionit të Paktit Atlantik të Rinisë së Kosovës (KYATA), që u mbajt në lokalet e Fakultetit Filozofik të Prishtinës.

Në konferencë morën pjesë edhe nënkryetarja e Parlamentit të Kosovës, deputetja Aida Derguti, anëtarja e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë, deputetja Ganimete Musliu, Dekani i Fakultetit Filozofik, prof. Bujar Dugolli, Kolonel Taibe Canolli nga Policia e Kosovës, Dajana Berisha nga Forumi për Iniciativë Qytetare, prof. Vjollca Krasniqi dhe Donika Emini nga Qendra Kombëtare për Studime të Sigurisë si dhe studentë dhe pjesëmarrës të tjerë. Major Remzie Zeqiraj, në emër të Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, foli për pozitën dhe rolin e femrave në FSK si dhe kontributin që ato po japin çdo ditë në zhvillimin dhe profesionalizimin e këtij institucioni. Në vazhdim, major Zeqiraj foli edhe për pozitën e femrës



ushtarake në FSK, duke shtuar se asaj i janë besuar detyra të rëndësishme komanduese si zëvendëskomandant, komandant kompanie, komandant togu, pas-taj shef sektori etj. Majorja Remzie Zeqiraj tha se FSK-ja ka krijuar ambient pune të përshtatshëm për të dyja gjinitë dhe në vazhdimësi garanton zhvillim profesional dhe ngritje në karrierë për të gjitha ushtaraket dhe femrat civile që shërbejnë në Ministri dhe Forcë. Në punimet e konferencës ku u bisedua për fuqizimin e grave në fushën e sigurisë foli presidenti i KYATA-s, Besim Salihu, i cili tha se kjo konferencë është tema e parë po edhe aktiviteti i parë që KYATA ka organizuar me rastin e shënimit të Javës së NATO-s në Kosovë. Të gjithë pjesëmarrësit në referatet dhe diskutimet e tyre treguan se kjo temë nuk është më e re dhe e panjohur. Në diskutim u inkuadruan edhe shumë studentë të cilët kontribuuan me diskutimet e tyre.

Shkrimtari Riza Greiçevci ia dhuroi 200 libra FSK-së

Në kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) në Prishtinë, u organizua një ceremoni me rastin e pranimit të një donacioni me libra nga shkrimtari, gazetari dhe publicisti i mirënjohur, z. Riza Greiçevci për Bibliotekën e FSK-së. Dhurimin e librave, e përshëndetën komandanti i Njësisë Ndërlidhëse për Reagim Ndaj Krizave (NJNRK) të Forcës së Sigurisë së Kosovës, nënkoloneli Milaim Musliu dhe drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak i Ministrisë së FSK-së, z. Hajrush Kurtaj. Zoti Kurtaj tha se kjo ndihmë është e një rëndësie të veçantë për ne, sepse librat janë dhuratë e çmuar nga shkrimtari i dalluar në shumë fusha krijuese, z. Riza Greiçevci. Ndërsa, z. Greiçevci tepër i emocionuar tha: "Është nder për mua, dhe e ndiej vetën të privilegjuar që pata mundësi ta ndihmojë Bibliotekën e FSK-së. Të gjitha këto libra janë krijime personale nga fusha të ndryshme letrare, ku pjesëtarët e FSK-së, kadetët, ushtarët dhe ata që janë studentët do të kenë mundësi të pajisen me dije. Biblioteka është simbol i punës dhe së ardhmes së ndritur të këtij populli. Besoj se kjo nuk do të jetë ndihma e parë dhe as e fundit e imja, tha në fund, z.



Greiçevci. Riza Greiçevci deri më tani ka shkruar dhe botuar mbi 75 vepra me tema të ndryshme, si romane, poezi, drama, ese, publicistikë etj. Biblioteka e Forcës së Sigurisë së Kosovës është themeluar më 12 prill të vitit 2011, dhe ka një numër të konsiderueshëm të librave (9000) nga të gjitha fushat, si ajo ushtarake dhe fusha e letërsisë. Deri më tani, me libra dhe literaturë të ndryshme Bibliotekën e FSK-së e kanë ndihmuar shumë institucione dhe individë, si Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, KFOR-i amerikan, veprimtarë dhe shkrimtarë të Kosovës, të cilët kanë dhuruar literaturë të shumëllojshme si nga letërsia, arti, historia, fizika, filozofia, literaturë të fushës ushtarake dhe zhanreve të ndryshme si dhe Kolegji Mbretëror i Danimarkës i cili i ka dhuruar Bibliotekës së FSK-së mbi 1000 libra.

Pjesëtarët e FSK-së përfunduan trajnimin për operacione civilo-ushtarake

Departamenti i BCU në bashkëpunim me Zyrën për Mbështetje Civilo-Ushtarake pranë Ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë, nga data 14-17 prill 2015, në ambientet e kazermës "Adem Jashari" organizuan trajnimin për operacione civilo-ushtarake në të cilin morën pjesë 27 pjesëtarë nga të gjitha njësitet e FSK-së. Qëllimi i mbajtjes së këtij trajnimi ishte që pjesëtarët e FSK-së, të përvetësojnë konceptin bazik lidhur me funksionimin e BCU-së, gjatë operacioneve për mbështetje humanitare në raste të krizave si brenda dhe jashtë vendit. Trajnimi është realizuar nga instruktorët amerikan, zotërinjtë Jeffrey Carroll dhe Kristofor Jacobson, ku janë trajtuar këto tema: Operacionet e kërkim-shpëtim, ndërmjetësimi, vetëdijësimi kulturor dhe etnik dhe

komunikimi me liderët kyç etj. Në fjalën e tij, atashu ushtarak i SHBA-ve, koloneli Chad Butts tha se Zyra për Bashkëpunim ka qenë dhe do të jetë në përkrahje të trajnimeve për pjesëtarët e FSK-së. Me këtë rast, Ai përshëndeti instruktorët dhe pjesëtarët e FSK-së të cilët kryen me sukses këtë trajnim katër ditor. Koloneli Butts shtoi se është me shumë rëndësi të dimë se si t'i dalim në ndihmë popullatës në rast nevojë. Trajnimet e tilla janë shumë më rëndësi, sepse mundësojnë t'iu qasemi problemeve si profesionist të vërtetë. Ndërsa, drejtori i Departamentit të BCU-së, z. Hajrush Kurtaj, fillimisht falënderoj Zyrën për Mbështetje Civilo-Ushtarake dhe ligjëruesit Jeffrey Carroll dhe Kristofor Jacobson, si dhe të gjithë ata që kontribuon në realizimin e

këtij trajnimi të suksesshëm. Ai shtoi se ky trajnim është i mirëseardhur dhe korrespondon me objektivat e ministrit, komandantit dhe të gjithë stafit udhëheqës të FSK-së, për përgatitjen e kuadrove me njohuri të avancuara në fusha të ndryshme. Bashkëpunimi Civilo-Ushtarak është njëri ndër elementet më të rëndësishme të zhvillimit të FSK-së. Ky bashkëpunim pranohet dhe avancohet gjithnjë e më shumë jo vetëm nga FSK-ja, por edhe nga partnerët tanë të jetës civile. Ne jemi të bindur se ky trajnim do t'na shërbejë shumë në kryerjen e detyrave profesionale në të ardhmen si në Kosovë ashtu edhe në misione humanitare dhe të mbështetjes jashtë vendit. Drejtori i BCU-së, z. Kurtaj, në emër të komandantit të FSK-së, gjeneralle-



jtënant Rrahman Rama, u dha mirënjohje për instruktorët amerikanë, Jeffrey Carroll dhe Kristofor Jacobson. Gjatë ceremonisë ishin të pranishëm Hajrush Kurtaj drejtor i Departamentit të BCU-së, atashu ushtarak i SHBA-ve, koloneli Chad

Butts, z. Jason Stumph-udhëheqës i ekipit Civilo-Ushtarak në Ambasadën Amerikane, majori Adam Giroux- Zyra për Bashkëpunim, majori Tom Melton- Zyra e Atasheut Ushtarak Amerikan si dhe zyrtarë dhe oficerë të lartë të Ministrisë dhe të FSK-së.

Intervistë me dy pjesëtare të FSK-së, nga radhët e komunitetit serb

Tetar Cvetanoviq: FSK-ja është institucioni që promovon siguri në Kosovë

"Forca Jonë": Kur jeni inkadruar në FSK dhe cila është pozita juaj?

Tetar Olivera Cvetanoviq: Jam pjesëtare e FSK-së që nga 21 janari i vitit 2009. Jam e sistemuar në skuadrën e Mjekësisë në Batalionin e Parë të Reagimit të Shpejtë, si teknike, këtu në Gjilan.



"Forca Jonë": Cili është bashkëpunimi juaj me pjesëtarët tjerë të FSK-së?

Tetar Olivera Cvetanoviq: Batalioni i Parë numëron 359 pjesëtarë. Në mesin e tyre ka pjesëtarë të komuniteteve të ndryshme. Unë si teknike mjekësore, në kuadër të punës që bëj, kam kontakte pothuajse me të gjithë pjesëtarët e batalionit. Dua të ju them së bashkëpunimi me ta është i shkëlqyeshëm dhe shpresoj të jetë kështu edhe në të ardhmen.

"Forca Jonë": Si e shihni veten në të ardhmen si pjesëtare të FSK-së?

Tetar Olivera Cvetanoviq: FSK-në e shoh si institucionin më të besueshëm në Kosovë, kështu mendoj se do jetë edhe në të ardhmen, një institucion që promovon siguri. Unë në të kaluarën kam qenë edhe pjesë e TMK-së, dhe me një numër të kolegëve



jemi duke punuar bashkë tash e sa vite, andaj nuk shoh as në të ardhmen ndonjë arsye që të mos punojmë së bashku edhe si kolegë të njëjtit institucion.

"Forca Jonë": Cila është porosia juaj për pjesëtarët e komunitetit tuaj dhe për gjithë rinjtë?

Tetar Olivera Cvetanoviq: Porosia ime për të gjithë qyte-

tarët e Kosovës jo vetëm të komunitetit serb, është: "Bëhuni pjesë e FSK-së sepse do të ndiheni krenar".

Ushtar Jovana Jovanoviq: Jam pjesëtare e FSK-së që nga gushti i vitit 2013. Jam e sistemuar në Togun e Tretë të Kompanisë 1C, Batalioni i 1-rë i Reagimit të Shpejtë. Me kolegët e Kompanisë 1C, por edhe me të gjithë pjesëtarët e batalionit kam një bashkëpunim të shkëlqyeshëm, ku dhe gjitha detyrat në kuadër të punës i realizojmë duke respektuar pozitën dhe marrëdhëniet kolegjiale. Mendoj se ky bashkëpunim i shkëlqyer do jetë

një vlerë për FSK-në tani dhe në të ardhmen. Deri me tani nuk kam pasur asnjë problem me kolegët, përkundrazi kam gjetur përkrahjen e tyre sa herë që kam pasur nevojë, e çmoj lartë bashkëpunimin nder kolegjial. Të qenit pjesë e FSK-së, për mua d. m. th. shumë. Së pari të ofron një punë me një pagë të arsyeshme dhe të sigurt, pastaj të bën të ndihesh mirë me respektin që të bëjnë kolegët. Mesazhi im për bashkëqytetarët është: "Bëhuni pjesë e FSK-së, sepse është institucion i mundësive të mëdha për të gjithë qytetarët pa asnjë dallim".

Nxënës dhe arsimtarë nga Suedia vizituan Kazermën e FSK-së në Gjilan

Në grup prej 43 nxënësish, së bashku me arsimtarët e tyre suedezë dhe shqiptarë, të cilët jetojnë dhe studiojnë në Suedi, vizituan Kazermën e Batalionit të Parë të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së në Gjilan. Kjo vizitë u realizua në kuadër të bashkëpunimit të FSK-së me Ministrinë e Diasporës së Kosovës. Nxënësit dhe arsimtarët e tyre nga Suedia u pritën nga kapiteni Blerim Sahiti dhe oficerë tjerë të FSK-së, të cilët i njoftuan me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, përkatësisht të Batalionit të Parë të BRSH-së. Pas prezantimit të të arriturave të FSK-së, ata u interesuan që të informohen për të arriturat e përgjithshme të FSK-së si dhe të mësojnë për



kriteret e pranimit të të rinjve në FSK. Më pas grupi nga Suedia vizitoi edhe ambientet e Batalionit të Parë si dhe përcolli nga afër një demonstrim të pjesëtarëve të këtij batalioni. Për nder të nxënësve dhe arsimtarëve nga Suedia, në ambientet e restorantit të FSK-së u shtrua një drekë e përbashkët ku drekuan së bashku nxënësit dhe ushtarët e FSK-së. Nxënësit dhe arsimtarët nga Suedia u ndanë të kënaqur me pritjen dhe me të arriturat e përgjithshme të FSK-së.

Studiuesi Zenun Rexhepi ia dhuroi FSK-së 8 tituj librash

Publicisti dhe shkrimtari i dalluar prof. Zenun Rexhepi i dhuroi Bibliotekës së Forcës së Sigurisë të Kosovës tetë (8) tituj librash me gjithsej 26 ekzemplarë, krijime personale, me dëshirën se ato do të jenë literaturë e dobishme për pjesëtarët e FSK-së dhe adhuruesit e librit.



Profesor Zenun Rexhepi fillimisht u prit nga komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe më pas edhe nga shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) kolonel Naim Haziri së bashku me stafin udhëheqës të Njësisë Ndërlidhëse për Reagim

Ndaj Krizave (NJNRK) të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Dorëzimin pranimit i librave u bë në ambientet e Bibliotekës të NJNRK-së, në një atmosferë bashkëpunimi dhe mirënjohje.

Me këtë rast, publicisti dhe shkrimtari Rexhepi u shpreh: "Shfaq kënaqësinë e veçantë që

m'u dha rasti t'i vizitoj dy institucionet tuaja të rëndësishme me rastin e dhurimit të disa prej titujve që i kisha në dispozicion. Më gëzon fakti se i pashë me sytë e mi të arriturat prej vitit 1999 e tutje, që janë vazhdimësi e luftës për çlirimin demokratik të Kosovës. Ju uroj edhe shumë suksese të reja për të mirën e shtetit të Kosovës dhe të popullit shqiptar në përgjithësi "-tha në fund të fjalës së tij publicisti Rexhepi. Ky aktivitet u koordinua nga drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak i Ministrisë së FSK-së, z. Hajrush Kurtaj.

Certifikohen pjesëmarrësit e trajnimit "Personi i Parë në Vendngjarje"

Në kazermën "Ushtarët e NATO-s" është mbajtur ceremonia e certifikimit të trajnimit "Personi i Parë në Vendngjarje". Ky trajnim u organizua nga Zyra e Atasheut Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar dhe u realizua nga pjesëtarët e Brigadës për Reagim të Shpejtë në Istog.

Në ceremoninë e certifikimit prezantuan: Gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione, kolonel Xhevahir Geci ushtrues i detyrës së komandantit të BRSH-së, kolonel David Jones këshilltar ushtarak i komandantit të FSK-së, kolonel Xhevdet Tahiraj, drejtor i Departamentit të Mjekësisë në MFSK-së, major Ejup Maqedonci, ushtrues i detyrës së shefit të Shtabit të BRSH-së, si dhe oficerë dhe ushtarë të FSK-së. Gjeneral brigade Zymer Halimi, me këtë rast, theksoi



rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm që ka FSK-ja me Mbretërinë e Bashkuar dhe kontributin që këta të fundit kanë dhënë dhe po japin në ngritjen profesionale të pjesëtarëve të FSK-së, përmes trajnimeve të tilla dhe të llojeve tjera. Gjeneral

Halimi falënderoi këshilltarin e KOMFSK kolonelin David Jones, për punën dhe për përpjekjet e tij të vazhdueshme në ngritjen dhe profesionalizimin e FSK-së. Ekipi i instruktorëve të Mbretërisë së Bashkuarë e ka vlerësuar shumë lart motivimin, angazhimin dhe



pjesëmarrjen e pjesëtarëve të FSK-së në këtë kurs. Të gjithë pjesëmarrësit e trajnimit kanë përfunduar me sukses testimin. Prej dy grupeve janë përzgjedhur 6 pjesëtarët më të mirë për të vazhduar me avancimin profesional të tyre për paramedikë dhe

trajnuar në të ardhmen.

Trajnimi është zhvilluar në dy grupe, nga data 30 mars deri më 10 prill 2015. Trajnimi "Personi i Parë në Vendngjarje" e kanë kryer 27 pjesëtarë të BRSH-së, përfaqësuar nga të tri batalionet e BRSH-së.

Në kursin Procedurat Shtabore Komanduese u certifikuan 15 pjesëtarë të FSK-së

Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, përfundoi kursi "Procedurat Shtabore Komanduese" të cilin e realizuan instruktorët e Qendrës Kolektive të Stërvitjes të KDS-së. Kursi ka zgjatuar katër javë dhe kanë marrë pjesë 15 pjesëtarë të njësive të ndryshme të FSK-së. Për rolin, rëndësinë, nivelin e përgatitjes dhe angazhimet gjatë këtij kursit, foli shefi i Shtabit të KDS-së kolonel Fadil Hadërgjonaj i cili ndër të tjera tha: " Ky kurs të cilin e



kanë ndjekur oficerë dhe nënoficerë të njësive të FSK-së, përgatitë pjesëtarët tanë për

udhëheqje dhe komandim të trupave, vlerësim të ushtrimeve, por edhe zhvillon udhëheqësin

në karrierën profesionale. Atë që ju keni treguar në këtë periudhë relativisht të shkurtër është shumë më rëndësi të theksohet se vetëm me një përkushtim të lartë arrihen këto rezultate. Është një e mirë që trajnimet në KDS janë duke u zhvilluar me metoda të kombinuara, teori dhe praktikë, ku pjesa kryesore ka qenë pjesë praktike, ndërsa testi final na ka dhënë të kuptojmë se pjesëtarët kanë treguar përkushtim gjatë këtij kursi"- përfundoi fjalën e tij, nënkolonel Hadërgjonaj.

Disa nga temat e kryesore të kursit kanë qenë: Alarmi, udhëheqja dhe komandimi, kontrolli, planifikimi, organizimi, vlerësimi i trajnimeve dhe ushtrimeve, procesi i planifikimit operacional, planet dhe urdhrat, dizajnim dhe funksionimi i shtabeve, sistemi i informative gjeografike (GIS) etj. Në fund, shefi i Shtabit të KDS-së, kolonel Fadil Hadërgjonaj dhe zëvendëskomandanti i Qendrës Kolektive të Stërvitjes, kapiten Avni Bunjaku, për pjesëmarrësit e kursit ndanë certifikata.

Kompania e Batalionit të Parë të BRSH-së përmbylli me sukses ushtrimin fushor "Ujku 1C Godet"

Kompania 1C e Batalionit të Parë të Brigadës për Reagim të Shpejtë e FSK-së, që nga data 31. 03. 2015 deri më 03. 04. 2015, ka realizuar ushtrimin fushor të koduar me emrin "Ujku 1C Godet". Ky aktivitet është realizuar në bazë të ciklit tremujor të trajnimeve dhe listës së detyrave esenciale për zbatimin e misionit dhe planit vjetor të aktiviteteve të Brigadës për Reagim të Shpejtë. Qëllimi kryesor i këtij ushtrimi ishte testimi i gatishmërisë operationale, funksionimi i nënoficerëve liderë në nivel kompanie, togu, skuadre dhe ekipi.

Kompania 1C me të pranuar

mesazhin e alarmimit, duke respektuar të gjitha afatet kohore ka ngritur gatishmërinë në nivelin e III-të, ku kërkohet që të jetë e gatshme që sipas urdhrat të operoi në zonën e operationit, për të kryer operationet e sigurisë. Në ushtrimin fushor të Kompanisë 1C, ishin të angazhuar 232 pjesëtarë, duke përfshirë këtu edhe personelin nga Komanda e Batalionit, Kompania Mbështetëse dhe Simulantët.

Ushtrimi fushor ishte tejet sfidues, ku personeli u ballafaqua me kushte të vështira atmosferike dhe skenarë të ndryshëm, të cilët i mundësonin Kompanisë 1C zhvillimin e operationeve të sig-



urisë dhe forcimin e trajnimeve paraprake. Aktivitetet/operationet u zhvilluan kryesisht në malet e Jezercit në regjionin e

Ferizajt, ku u testua edhe komunikimi me Radio Harris dhe Motorola. Ky aktivitet zgjati tri ditë, duke i mundësuar personelit

të K1C të realizojë një mori aktivitete të cilat janë mësuar gjatë fazës së trajnimit. Aktivitetet e realizuara gjatë ushtrimit fushor ishin: alarmimi, marshimi, ngritja e kampit fushor, ngritja e komandave taktike, navigimi natën, operatione urbane, operatione malore, pikë vëzhgimi, pikë kontrolli, kontrolli i zonës, koordinimi me autoritetet lokale dhe testimi i qëndrueshmërisë fizike. Ushtrimin fushor e përcollën nga afër dhe përfaqësuesit e NLAT-it, ekipit këshillues të NATO-s për FSK-në. Ushtrimi fushor "Ujku 1C Godet" ka përfunduar me sukses, duke arritur kështu edhe qëllimin e mbajtjes së tij.

Kontingjenti i KFOR-it Turk trajnoi pjesëtarë të Batalionit të Parë të BRSH-së në Gjilan

Në Gjilan u mbajt ceremonia e certifikimit të 28 të pjesëtarëve të Kompanisë 1A, të Batalionit të Parë të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, të cilët përfunduan me sukses trajnimin tre mujorë (12 janar 2015 deri më 02 prill 2015), me ekipet e

KFOR-it turk. Në ceremoninë e certifikimit, ushtruesi i detyrës së komandantit të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, kolonel Xhevahir Gaci falënderoi ekipet turke që tash e sa vite janë duke i trajnuar njësitë e Brigadës për Reagim të Shpejtë dhe kërkoi

nga pjesëtarët të cilët sapo kanë përfunduar këtë trajnim që njohuritë e tyre t'i përcjellin në njësitet ku shërbejnë. Ndërsa, koloneli Demirgjoğlu përgëzoi pjesëtarët e Kompanisë 1A dhe premtoi se do vazhdojnë me trajnime të tilla edhe në të

ardhmen. "Përkushtimi dhe entuziazmi i instruktorëve dhe pjesëtarëve në këtë trajnim ka qenë në nivelin më të lartë, gjë që ka bërë që trajnimi të jetë më atraktiv dhe shumë frytdhënës"- tha ushtruesi i detyrës së komandantit të Batalionit të Parë, major

Ibrahim Revuqi.

Pjesëtarët të cilët kanë ndjekur këtë trajnim kanë marrë njohuri të reja në ngritjen e shkathtësive individuale dhe kolektive, njohuri këto që do tu shërbejnë për zhvillimin e forcës, u tha gjatë ceremonisë.